

L I G J

Nr. 72/2014

PËR PËRDORIMIN E ARMËVE TË ZJARRIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është standardizimi dhe përcaktimi i mënyrës së përdorimit të armëve të zjarrit nga punonjësit e policisë dhe subjekte të tjera, të cilëve ligji në fuqi u njeh përdorimin e armëve të zjarrit, në përmbushje të detyrave të tyre.

Neni 2 Objekti dhe fusha e veprimit

1. Ky ligj përcakton mënyrën dhe parimet e përgjithshme të përdorimit të armëve të zjarrit nga subjektet, të cilave përdorimi i tyre u është njohur me ligj.
2. Ky ligj është i detyrueshëm për punonjësit e Policisë së Shtetit, për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kur përdoren për vendosjen e rendit vetëm në rastet kur forcat e policisë nuk janë në gjendje ta kryejnë atë, si dhe për subjekte të tjera që janë të pajisura me armë zjarri në bazë të një ligji të posaçëm.
3. Në rastet kur përdorimi i armëve të zjarrit kërkohet për plotësimin e drejtpërdrejtë të misionit të mbrojtjes së pavarësisë, tërësisë territoriale dhe të rendit kushtetues të Republikës së Shqipërisë apo të një misioni jashtë vendit, të caktuar nga autoritetet kompetente, përdorimi i tyre bëhet sipas rregullave të angazhimit, të miratuara nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, në zbatim të misionit të caktuar dhe në përputhje me legjislacionin e brendshëm e atë ndërkombëtar të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "Punonjës policie" është personi i emëruar në strukturat e policisë që mban gradë policore, sipas ligjit për Policinë e Shtetit;
- b) "Subjekte të tjera" janë punonjësit e Policisë së Burgjeve, Shërbimit Informativ të Shtetit, Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike, Forcave të Armatosura, si dhe subjektet e tjera që janë pajisur me armë zjarri në bazë të një ligji të posaçëm;
- c) "Mjet i fundit" është arma e zjarrit si mjeti ekstrem i përdorimit të forcës, kur mjetet e tjera që përdoren nga subjektet e këtij ligji nuk kanë dhënë rezultat ose kur duket qartë se përdorimi i tyre nuk do të ketë sukses;
- ç) "Vend i qëndrimit të detyrueshëm të personit" është institucioni i paraburgimit ose burgimit, banesa, territori, spitali psikiatrik, vendi ku detyrohet të qëndrojë personi, ndaj të cilit është vendosur një masë sigurimi personal e karakterit shtrëngues;

d) "Armë zjarri" janë mjetet e përcaktuara në ligjin në fuqi për armët në Republikën e Shqipërisë.

dh) "Objektiv i ligjshëm" është synimi që ndjekin subjektet e këtij ligji gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe me ligjin në fuqi.

Neni 4

Kushtet e përdorimit të armës

1. Punonjësit e Policisë së Shtetit dhe subjektet e tjera mund ta përdorin armën e zjarrit të shërbimit, në ushtrim të detyrave të tyre dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji, vetëm atëherë kur është absolutisht e domosdoshme dhe vetëm si mjet i fundit për të parandaluar ose neutralizuar veprimet e dhunshme të rrezikshme të personit me rrezikshmëri të lartë për jetën dhe shëndetin e tij dhe personave të tretë, kur mjetet e tjera të përdorimit të forcës nuk kanë dhënë rezultat ose nuk arrijnë objektivat e ligjshëm të detyrave funksionale.

2. Shmangia e një rreziku nëpërmjet përdorimit të armëve të zjarrit nga subjektet që u njihet kjo **e drejtë**, bëhet për të mbrojtur jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tyre ose të një tjetri nga një sulm i padrejtë, i vërtetë dhe i çastit, me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit, si dhe kur u kërkohet për të përballuar një rrezik real dhe të çastit, që kërcënon atë ose një person tjetër apo pasurinë e tyre nga një dëmtim i rëndë, me kusht që të mos jetë i provokuar prej tij dhe dëmi i shkaktuar të mos jetë më i madh se dëmi i zmbursur.

Neni 5

Evidentimi i armëve të zjarrit në regjistrë

1. Punonjësit e Policisë së Shtetit dhe subjektet e tjera që janë pajisur me armë zjarri, në bazë të një ligji të posaçëm, të cilët janë të autorizuar të mbajnë e të përdorin armë zjarri dhe municion përkatës, duhet t'i evidentojnë ato në regjistrat e njësive ku subjektet shërbejnë.

2. Mënyra e evidentimit, forma dhe formati i regjistrit rregullohen nga ligji për armët.

Neni 6

Përgjegjësia për pasojat e përdorimit të armës

1. Punonjësit e policisë apo subjektet e tjera, të cilat përdorin armë zjarri, **kanë përgjegjësi personale**, përveç rasteve në të cilat punonjësi është në përbërje të njësisë që vepron në një operacion policor ose ushtarak, në zbatim të nenit 173, pika 2, të Kushtetutës, dhe kur urdhri i dhënë nga drejtuesi i operacionit për të qëlluar nuk është i kundërligjshëm.

2. Punonjësit e Policisë së Shtetit dhe subjektet e tjera, kur përdorin armët e zjarrit në kundërshtim me këtë ligj, përgjigjen penalisht, sipas llojit të veprës penale të kryer, në përputhje me legjislacionin penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 7

Shmangia e rrezikut publik

1. Përdorimi i armëve të zjarrit për të shmangur një rrezik publik, që paraqet një tubim i dhunshëm personash, duhet të bëhet në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

2. Përdorimi i armëve të zjarrit është i lejueshëm vetëm kundër personave të veçantë të armatosur, të cilët kryejnë vepra të dukshme dhune kundër jetës së personit ose shërbimeve të policisë dhe shërbimeve që kryejnë subjektet e tjera që mbajnë dhe përdorin armë, kur përdorimi i masave të tjera shtrënguese nuk ka dhënë rezultatet e dëshiruara.

3. Ndalohet të qëlluarit në ajër me armë zjarri mbi grumbullime njerëzish, si një mënyrë për shpërndarjen e tyre.

Neni 8

E drejta për përdorimin e armës së zjarrit

1. Punonjësit e policisë dhe subjektet e tjera, në përmbushje të detyrave funksionale përkatëse, mund të përdorin armët e zjarrit nëse nuk ka mënyrë tjetër:

a) për të mbrojtur jetën dhe shëndetin tij, si dhe jetën e personave të tjerë nga sulme të pashmangshme ose për të parandaluar vazhdimësinë e aktit kriminal që shkakton rrezik të lartë për jetën;

b) për të arrestuar ose penguar largimin e një personi që u reziston me dhunë urdhrave të ligjshëm të dhënë nga punonjësi i policisë dhe me veprimet e tij paraqet rrezik qartësisht të dukshëm për jetën e punonjësit të policisë ose personave të tjerë;

c) për të parandaluar largimin nga vendi i qëndrimit të detyrueshëm të personit që paraqet rrezik të pashmangshëm për jetën e personave të tjerë dhe që nuk u bindet urdhrave të ligjshëm të dhënë nga punonjësi i policisë;

ç) për të zbrapsur sulmin ndaj një objekti publik ose privat, nëse është qartësisht e dukshme që jeta e personit, i cili e siguron atë, ose personave të tjerë është në rrezik.

2. Këshilli i Ministrave miraton rregulla të detajuara për përdorimin e armëve të zjarrit.

Neni 9

Paralajmërimi për përdorimin e armës së zjarrit

1. Përpara përdorimit të armëve të zjarrit punonjësit e policisë dhe subjektet e tjera duhet të identifikojnë veten si të tillë, si dhe t'i japin një paralajmërim të qartë, duke u shprehur me zë të lartë "Ndal", ndjekur nga paralajmërimi i dytë "Ndal se do të qëlloj", nëse ai nuk ndalet.

2. Në rrethana objektive të pamundura, të ngutshme, mund të mos bëhet paralajmërimi në rast se një veprim i tillë rrezikon subjektet e këtij ligji ose personat e tjerë nga një rrezik i çastit për jetën. Në këtë rast qëllohet pa paralajmërim, duke synuar në pjesët e poshtme të trupit.

Neni 10

Përdorimi i armëve të zjarrit ndaj kafshëve

1. Armët e zjarrit përdoren kundër kafshëve nga subjektet e këtij ligji, në rast se ato përbëjnë rrezik të menjëhershëm sulmi ndaj jetës ose rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve nga sëmundje infektuese.

2. Armët e zjarrit përdoren kundër kafshëve të sëmura dhe të plagosura rëndë, që cenojnë shëndetin publik, kur nuk ekziston mundësia që një veteriner apo pronari të ndërmarrë masat e nevojshme për kurimin e tyre.

3. Punonjësi i policisë që vret kafshë të egra, në kushtet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, informon për këtë rast strukturën e shërbimit pyjor përkatës dhe menaxhuesin e zonës së gjuetisë.

Neni 11
Komisioni i shqyrtimit të rasteve të përdorimit të armës

1. Për analizimin e rasteve, në të cilat është përdorur arma e zjarrit nga punonjësit e policisë dhe nuk kanë ardhur pasoja për jetën ose shëndetin e personit, krijohet komisioni për shqyrtimin disiplinor të rasteve të përdorimit të armëve të zjarrit dhe përgjegjësit e drejtuesve të policisë.
2. Komisioni ka për detyrë të përcaktojë:
 - a) nëse përdorimi i armës së zjarrit është bërë në përputhje me standardet të dhëna në Manualin e Politikave dhe Procedurave të Policisë së Shtetit;
 - b) të bëjë rekomandime për përmirësim ose ndryshim të trajnimit, menaxhimit dhe politikave e procedurave të shërbimit të Policisë së Shtetit;
 - c) të propozojë masa disiplinore kur janë shkelur procedurat standarde nga personat përgjegjës.
3. Përbërja dhe procedurat e funksionimit të këtij komisioni përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Punëve të Brendshme.

Neni 12
Detyrimi për trajnim

1. Policia e Shtetit duhet të sigurojë që punonjësit e policisë dhe subjektet e tjera, në kuptim të këtij ligji, me përjashtim të Forcave të Armatosura, të kryejnë trajnimin dhe testimin në përputhje me standardet e vendosura për përdorimin e armëve të zjarrit dhe të autorizohen të mbajnë armë zjarri vetëm pas certifikimit të veçantë për këtë qëllim.
2. Trajnimi i punonjësve realizohet sipas ligjeve dhe akteve nënligjore organike që normojnë veprimtarinë e tyre.

Neni 13
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë akte nënligjore në zbatim të nenit 8, pika 2, të këtij ligji.
2. Ngarkohet Ministri i Punëve të Brendshme që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë udhëzimin në zbatim të pikës 3, të nenit 11, të këtij ligji.

Neni 14
Shfuqizime

Ligji nr. 8290, datë 2.4.1998, "Për përdorimin e armëve të zjarrit", i ndryshuar, si dhe çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Miratuar në datën 10.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8648, datë 30.7.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

